

VENDIM
Nr.1612, datë 10.10.2008

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË
GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2007, PËR PROJEKTIN
“SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KORÇA IV”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve e marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar, 2007, për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korça IV”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM
FINANCIAR, 2007
(SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA, KORÇË IV)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;
me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 16 tetor 2007,
u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose një huamarrësi tjetër që do të zgjidhet bashkërisht nga të dy qeveritë, të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau (KfW) një hua të kombinuar, e cila jepet në kuadër të bashkëpunimit publik në fushën e zhvillimit, me vlef të prej deri në 15.000.000 euro (me fjalë: pesëmbëdhjetë milionë euro) për projektin “Shkarkimi i ujërave të zeza, Korçë IV”, kur nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se – duke gjykuar nga aspekti i politikës së zhvillimit – projekti vlen për t’u mbështetur, kur Republika e Shqipërisë vazhdon të jetë mjaft e besuar për kredi, dhe kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rast se ai vetë nuk do të jetë kredimarrës,

jep një garanci shtetërore. Projekti në fjalë nuk mund të zëvendësohet me projekte të tjera.

2. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditansalt für Wiederaufbau hua të tjera ose shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 ose shuma të tjera financimi për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, atëherë gjen zbatim kjo Marrëveshje.

3. Shumat e financimit për masa përgatitore dhe shoqëruese sipas paragrafit 2 do të kthehen në hua, në rast se nuk përdoren për masa të tilla.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditansalt für Wiederaufbau dhe huamarrësve, kontrata të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1 paragrafi 1 do të zhvleftehet, në rast se kontratat përkatëse për marrjen e huasë dhe për financimin nuk përfundohen brenda një afati prej tetë vjetësh pas vitit të premimit. Për shumën në fjalë ky afat mbaron më datë 31 dhjetor 2015.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai nuk është vetë huamarrësi, do të garantojë ndaj Kreditansalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat në euro për shlyerjen e borxheve të huamarrësve në bazë të kontratave që do të përfundohen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e liron Kreditansalt für Wiederaufbau nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike, të cilat merren në Republikën e Shqipërisë, lidhur me përfundimin dhe zbatimin e kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i lejon pasagjerët dhe furnizuesit t'i zgjedhin lirisht ndërmarrjet transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e huasë dhe e shumave të financimit, nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me qendër në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr në rast se duhet lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 7.10.2008, në dy origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.